



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 254/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Murati D” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Blerje materiale Higjeno-Sanitare për Bashkinë dhe Njësitë e Varësisë për vitin 2019”, me nr. REF-04071-01-16-2019, me fond limit 1,266,609 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k.  
Adresa: Rruga e Kavajës, ish Kombinati Ushqimor, godina 1 - katëshe, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Librazhd  
Adresa: “Sheshi Gjorg Golemi”, Librazhd.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### **Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

#### **Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 17.01.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Kërkesë për Propozim – Marrëveshje kuadër”, me objekt “Blerje materiale Higjeno-Sanitare për Bashkinë dhe Njësitë e Varësisë për vitin 2019”, me nr. REF-04071-01-16-2019, me fond limit 1,266,609 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

II.2 Në datën 28.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 06.02.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “Anbim” shpk	3690.60 lekë, Skualifikuar;
2. ”Euro mega 2010” shpk	3797.00 lekë, Skualifikuar;
3. “Murati D” shpk	4433.00 lekë, Skualifikuar;
4. “Atlantik 3” shpk	5105.00 lekë, Skualifikuar;
5. “Irdi Gega” pf	5282.90 lekë, Kualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Murati D” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“3.1. Te skualifikojë operatorin ekonomik MURATI –D shpk, për shkak se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plotë dhe të saktë sipas shtojcës 8 të DT: Konkretisht; “2.2.2. Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifën vendore për vitin 2017 dhe 2018 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-se). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifën vendore)”. Operatori Ekonomik ka paraqitur në SPE, vërtetim për pagimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2016-2017 nga Bashkia e Tiranës, vërtetim jo origjinal, dhe i panoterizuar, në të cilin edhe vula identifikuese e bashkisë së Tiranës nuk duhet aspak. KVO gjykon dhe vendos se ky dokument është i pasaktë, dhe jo origjinal dhe i panoterizuar. Operatori Ekonomik ka patur të gjithë kohen e nevojshme për përparatjen e dokumentacionit për këtë prokurim, dhe në asnjë moment nga botimi në SEP të dokumentave të tenderit deri në ditën e hapjes së ofertave asnjë nga operatorët ekonomik nuk ka si dhe asnjë operator tjetër nuk ka patur e paraqitur pretendime apo kërkesë për sqarim për këtë kriter për kualifikim apo me specifikisht. Duke mos patur paqartësi atëherë, operatorët kanë qenë të detyruar të përparatistë e paraqistë oferta dhe dokumentacionin shoqerues sic është kërkuar nga AK. Në shtojcën 8, parashikohet se .....rastet e mosdorzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Në DST parashikohet se : Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Në këtë rast KVO është e detyruar të zbatojë përcaktimet e nenit 55/2 të LPP, pra të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT. Ligji nuk i jep mundësi KVO që sipas rastit apo sipas operatorëve pjesëmarrës, një kriter për kualifikim ta marrë në konsideratë, dhe ndonjëherë tjetër të mos e marrë në konsideratë. Në të kundërt do të veprohet në kundërshtim me parimet e transparencës, barazisë dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. K.V.O thekson se edhe nëse nuk do kishte arsye tjetër skualifikimi për këtë operator ekonomik, mosrespektimi i V.K.M dhe kriterit të vendosur në DT, përben arsye të mjaftueshme për skualifikim. Në nenin 36 të LPP, parashikohet se : Neni 36 Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike 1. Pa cenuar parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit dhe dispozitat e nenit 22 të këtij ligji, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve të transmetimit elektronik, si më poshtë: a) informacionet, që lidhen me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, përfshirë enkriptimin, janë në dispozicion të palëve të interesuara. Mjetet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe me legjislacionin përkatës; b) ofertat elektronike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik, si dhe për bazat e të dhënave shtetërore; c) përpara përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, ofertuesit marrin përsipër të paraqesin dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë, të përmendura në nenet 45 dhe 46 të këtij ligji, nëse këto të fundit nuk ekzistojnë në format elektronik.” Neni 46 Kualifikimi i ofertuesve 1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurimet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtarinë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerinë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë

organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur; ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.” Në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. Persa me sipër KVO vendos të skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk.

3.2. Te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk, për shkak se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte sipas shtojcës 8 të DT:Konkretisht; KVO vendos dhe gjykon se Operatori Ekonomik MURATI –D shpk, nuk krijon besueshmëri dhe nevojshme për tu shpallur si operator ekonomik i kualifikuar, pasi në deklaratat dhe shtojcat e paraqitura në SPE janë vulosur dokumentat në dy vula të ndryshme. KVO e gjykon të rëndësishme faktin e krijimit të besueshmërisë ndaj një operatori ekonomik për të përmbushur realizimin e kontratës me sukses. Fakti që dokumentat, shtojcat, deklaratat e paraqitura në SPE nga OE MURATI – D, janë në vulosura nga dy vula të ndryshme, KVO nuk ka besueshmëri ndaj këtij operatori ekonomik mbi vërtetësinë e dokumentit të paraqitur në SPE, pasi një operator ekonomik, ka një emertim të caktuar i cili koresponduar dhe me faktin e rregjistrimit në QKB dhe një nënshkrim dhe vule të caktuar identifikuese, dhe jo me shumë. Në ditën e hapjes së ofertave në SPE, operatori ekonomik nuk mund të paraqesë në SPE për të njëjten ditë, date 28.01.2019, dokumenta dhe deklarata të vulosura nga dy vula të ndryshme, pasi has konfuzion dhe pavërtetësi, pasaktësi të dokumentave të paraqitura në SPE. Konkretisht OE MURATI –D shpk, deklaraten për marrjen persiper të shpërndarjes së mallrave deri në destinacionet perkatese të njesise bashkise, e cila mban datën 28.01.2019 dhe nr. 501 prot është firmosur nga administratori Dervish Murati dhe ka vule të ndryshme nga deklaratat e tjera, te po kesaj data (dita e hapjes se ofertave dt.28.01.2019) si psh. Deklarate liste e informacionit konfidencial, deklarate mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, deklaratare për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme etj. Si mundën që dokumentat e nënshkuara në të njëjten ditë, nga i njëjti administrator të jenë të vulosura nga dy vula të ndryshme? Në Vendimin nr. 390, date 06.08.1993, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit, dhe ruajtjen e vulave zyrtare”, i ndryshuar, parashikohet se: “Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë detyrohen të kenë vulën e tyre zyrtare prej gome ose plastike dhe shënimet e nevojshme identifikuese”. Nisur nga sa më lart, KVO gjykon se, operatori ekonomik ankimes MURATI – D, sh.p.k nuk ka respektuar formën e paraqitjes së deklaratave të kërkuara në kriteret e kualifikimit të dokumentave të tenderit. Aktet e prodhuara nga një person juridik privat, duhet të përmbajnë të gjithë elementët thelbësorë që i bejnë ato të vlefshme si nga ana formale dhe ajo materiale. Ndër elementët thelbësorë të aktit zyrtar të lëshuar nga një person juridik që identifikon përkatësinë e tij, janë firma dhe vula. KVO, në analizë të deklaratave të paraqitura nga operatori ekonomik MURATI – D në sistemin e prokurimeve elektronike, të cilat janë të një rëndësie të vecantë në një procedurë prokurimi, gjykon se firmosja e deklaratave në dy vula të

ndryshme, nuk japin garanci për autoritetin kontraktor për përmbushjen dhe realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Këto deklarata nuk janë plotësuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe Dokumentat Standarde të Tenderit, të cilat janë të detyrueshme të përmbushen nga ofertuesit, në të gjithë elementët që përmbajnë këto deklarata, përfshirë edhe vulosjen e tyre me vulën e shoqërisë për identifikimin e saj dhe nënshkrimin e ofertuesit, sic është kërkuar në DST. Ne DST parashikohet se : Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Kete qendrim e mbeshtesim edhe me praktiken vendimmarrese te KPP, konkretisht vendimi 704/2015. Persa me siper KVO vendos te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk

3.2. Te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk, per shkak se operatori ekonomik nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte sipas shtojces 8 te DT: Konkretisht; b. Deklararimi i Konfliktit te Interesit sipas Shtojces 7; Operatori Ekonomik MURATI –D shpk, ka paraqitur ne SPE , nje dokument per te permbushur deklaraten e konfliktit te Interesit sipas shtojces 7 te DST, por qe KVO gjykon dhe vendos se eshte e pa sakte dhe e parregullt pasi deklarata nuk ka te gjitha pjeset perberese te saj ne menyre te rregullt sipas percaktimit ne DST, dmth nuk permbush te gjitha elementet e saj formale dhe ne thelb per tu cilesuar si nje dokument i vlefshem. KVO gjykon dhe vendos se ky dokument eshte i pasakte. Operatori Ekonomik ka patur te gjithë kohen e nevojshme ne pergatitjen e dokumentacionit per kete prokurim, dhe ne asnje moment nga botimi ne SEP te dokumentave te tenderit deri dite e hapjes se ofertave asnje nga operatori ekonomik nuk ka si dhe asnje operator tjetër nuk ka patur e paraqitur pretendime apo kerkese per sqarim per kete kriter per kualifikim apo me specifikisht. Duke mos patur paqartesi atehere, operatoret kane qene te detyruar te pergatiste e paraqiste oferte dhe dokumentacionin shoqerues sic eshte kerkuar nga AK. Ne shtojcen 8, parashikohet se .....rastet e mosdorëzimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim. Ne kete rast KVO eshte e detyruar te zbatoje percaktimet e nenit 55/2 te LPP, pra te vleresojë përmbushjen e cdo kriteri per kualifikim qe gjendet ne DT. Ligji nuk i jep mundesi KVO qe sipas rastit apo sipas operatoreve pjesemarrës, nje kriter per kualifikim ta marrë ne konsiderate , dhe ndonjeher tjetër te mos e marrë ne konsiderate. Ne te kundert do te veprohet ne kundërshtim me parimet e transparences, barazise dhe trajtimit te barabarte te ofertuesve pjesemarrës ne kete procedure prokurimi. Ne DST parashikohet se : Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Persa me siper KVO vendos te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk

3.3. Te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk, per shkak se operatori ekonomik nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte sipas shtojces 8 te DT, konkretisht parimin e pergjithshem dhe kriterin se : Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. KVO ka konstatuar se ne te gjithë dokumentacion e paraqitur nga OE MURATI\_D shpk , ne SPE, eshte bere punim mbi dokument apo nenshkrim mbi dokument, duke e bere kete dokumentacion te paraqitur jo te sakte, apo te parregullt. Sa me siper Vertetimi qe konfirmon shlyerjen e energjise elektrike, kontrata qe vertetojne kapacitetin teknik si sherbim i ngjashem, vertetimet qe konfirmojne pagimin e taksave dhe tarifave vendore, jane te ripunuara, dhe te nenshkruara mbi dokument, duke u shmangur keshtu nga forma e tyre origjinale , ashtu sikurse kane apo duhet te kene formatin e tyre origjinal. Parimi i pergjithshem ne paraqitjen e te gjithë dokumentacionit ne SPE eshte qe dokumentat duhet te jene origjinale, dmth te pacenuara, te pa nenshkruara mbi dokumentat, ose kopje te noterizuara, ne te kunderten

konsiderohen te paverteta apo te pasakta. Sa me siper KVO e gjykon te rendesishme faktin e krijimit te besueshmerise ndaj nje operatori ekonomik per te permbushur realizimin e kontrates me sukses, dhe fakti qe nje pjese te dokumentacionit te paraqitur ne SPE nga OE MURATI – D, jane te ripunuara, apo te nenshkruara mbi dokument nuk krijon bindjen dhe besueshmerine mbi qenien e tyre te sakta, te rregullta, dhe origjinale. Persa me siper KVO vendos te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk.

3.4.. Te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk, per shkak se operatori ekonomik nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte sipas shtojces 8 te DT: Konkretisht : d)vertetim qe konfirmon se ka shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i rregjistruar ne Shqiperi. OE MURATI – D shpk ka paraqitur ne SPE vertetim qe konfirmon shlyerjen e energjise elektrike me date 10552 prot, date 23.12.2018 sipas se cilit jane shlyer detyrimet te maturuara te energjise elektrike deri ne muajin nentor 2018, dhe jo per muajin dhjetor 2018. Per me teper ky vertetim duket sikur eshte ripunuar apo nenshkuar mbi te, dhe nuk te krijon aspak binden se eshte i sakte. Sa me siper KVO vendos qe OE nuk ploteson kriterin per shlyerjen e energjise elektrike sipas normativave ligjore ne fuqi. Persa me siper KVO vendos te skualifikoje operatorin ekonomik MURATI –D shpk”

II.5.Në datën 12.02.2019 operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]1-Thuhet se dokumenti i pageses se taksave i viteve 2016-2017 eshte i perpunuar pra i thene ndryshe i rreme. Sqarojme se ky dokument ka firmen dhe vulen origjinale te bashkise KVO abuzon e hedh dyshime sepse sipas tyre nuk duket vula e bashkise ku kjo nuk qendron pasi jane dokumentat e derguara origjinale fizikisht e jo me vetem ne pdf.

2-Thuhet se KVO shprehet mosbesues pasi dokumenti qe deklaroi marrjen persiper te shperndarjes se mallit sipas nevojës se AK te vendosur nje vule me dimensione te ndryshme por me nenshkrimin e shoqerise "MURATI D" dhe me nenshkrimin tone si te gjitha deklaratat tjera. Duke u nisur nga ky fakt qe nuk eshte as fallsifikim pasi eshte e shoqerise pasi shoqeria disponon dy vula nje te madhe qe rrin ne zyre dhe nje tjeter qe perdoret ne munges te saj por qe te dyja jane te Shoqerise : "MURATI D" me te njejtin sigel me te njejtin nenshkrim. Duhet ti kujtoj KVO se sipas LPP mjafton qe njera nga SIGLAT e shoqerise te jete ne nenshkrim praa -vula-ose firma e administratorit dhe dokumenti eshte i vlefshem. Me fale te tjera si ka mundesi qe te hidhet poshte sigma e shoqerise vetem e vetem per te interpretuar te pa verteten dhe per te fittuar ne deshmi reale e te plota.

3-Thuhet se shtojca 7-eshte e perpunuar dhe mungojn element te saj. Nuk e kuptoj cfare mungon ne kete deklarate cfare eshte perpunuar etj te gjitha te pa verteta sepse kesaj deklarate te cilen KVO e ka ne sistem dhe asnje fjale e tij dokumenti nuk eshte shtuar apo hequr nga ai qe ka shpallur APP ne DST. Pra edhe me kete fakt pervec hipotezave te KVO nuk egziston asnje rezultat i rreme sic e iterpertojne KVO.

Se kateri, Vertetimi i energjise se shlyer i dates 28.12.2018 me nr portokalli 10552 eshte i perpunuar ku ky vertetim eshte i skanuar ne pdf origjinal dhe ne se kuptojm se ku eshte perpunimin ne cilen shifer apo shprehje cfare ka ketu te rreme ku niset K VO qe ben kete akuze ku e marrin kete inisiative ky komision Me poshte thuhet se ne vertetim thuhet se shoqeria "MURATI D" ka detyrime 0 leke te faturave te energjise deri me 27.12.18 duke mos perfshire faturen e muajit dhjetor" me poshte KVO thekson se nuk eshte paguar muaj dhjetor 2018. Ju kujtoj se kjo fature ka kohe te paguhet deri me 31.01.2019 kjo pranohet me ligj te PP prandaj i rekomandoj te konsultohen me ligjen e PP Ky vertetim shpreh vetem te verteten dhe eshte origjinal. [...]"


II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 995/1 Prot. datë 14.02.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Murati D” sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.7.Në datën 21.02.2019 operatori ekonomik ”Murati D” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8.Në datën 01.03.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1262/1prot., datë 27.02.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.9.Në datën 25.03.2019, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., lidhur me autenticitetin e vërtetimit të debisë, të paraqitur elektronikisht në SPE nga ankimuesi, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit.

II.10.Në datën 19.04.2019, me anë të shkresës nr.3747/1prot., datë 17.04.2019, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., ka dërguar informacionin e kërkuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.



pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

### **Arsyeton:**

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ”Murati D” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : “[...]Operatori Ekonomik MURATI –D shpk, ka parqitur ne SPE , nje dokument per te permbushur deklaraten e konfliktit te Interesit sipas shtojces 7 te DST, por qe KVO gjykon dhe vendos se eshte e pa sakte dhe e parregullt pasi deklarata nuk ka te gjitha pjeset perberese te saj ne menyre te rregullt sipas percaktimit ne DST, dmth nuk permbush te gjitha elementet e saj formale dhe ne thelb per tu cilesuar si nje dokument i vlefshem [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 2.1 gërma b, të shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: ” b. Deklararimi i Konfliktit te Interesit sipas Shtojces 7”

III.1.2.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

III.1.3. Në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.1.4. Ndërsa në nenin 16 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Ky deklaram garanton autoritetin kontraktor që ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Ai përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.”*

III.1.5. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), Deklaratën e Konfliktit të Interesit, sipas shtojcës nr.7.

III.1.6. Nga verifikimi i shtojcës nr.7, të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky dokument është paraqitur jo sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pasi mungon një prej elementëve formal më të rëndësishëm të saj. Operatori ekonomik ankimues ka ngarkuar në SPE deklaratën e konfliktit të interesit të nënshkruar vetëm në faqen e parë të shtojcës, ndërsa në faqen e dytë të kësaj deklarate mungon nënshkrimi nga përfaqësuesi ligjor i subjektit. Komisioni thekson se pjesa e dytë e shtojcës e cila nuk është nënshkruar nga ankimuesi, është pjesa më e rëndësishme e këtij dokumenti, pasi në këtë pjesë bëhet plotësimi i emrit të përfaqësuesit ligjor të operatorit ekonomik, emërtimi i personit juridik që përfaqëson përfaqësuesi, data e nënshkrimit, emri/mbiemri/ nënshkrimi/vula e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, që janë dhe thelbi i këtij dokumenti të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, të procedurës objekt prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, qëllimi dhe vlefshmëria e dorëzimit të këtij dokumenti, qëndron në plotësimin dhe nënshkrimin/vulosjen e asaj. Ngarkimi në SPE, me nënshkrim vetëm në faqen e parë të shtojcës nr.7 dhe jo në faqen e dytë ku është përcaktuar se duhet të jenë të dhënat, nënshkrimi dhe vula e subjektit, e bën të pavlefshëm këtë dokument, pasi, mungon një prej elementëve kryesor formal të një deklarate, e për rrjedhojë humb thelbin dhe arsyen e kërimit të saj. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.1 gërma b, të shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Murati D” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.



Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ”Murati D” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim – Marrëveshje kuadër*”, me objekt “*Blerje materiale Higjeno-Sanitare për Bashkinë dhe Njësitë e Varësisë për vitin 2019*”, me nr. REF-04071-01-16-2019, me fond limit 1,266,609 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 28.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 268 protokoli Datë 21.02.2019;**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Anëtar  
**Lindita Skeja**

Anëtar  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**